



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.1068/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić Kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Alban Mazerku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1068/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Alban Mazreku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet: 3016A/01R, 3013A/01R dhe 3013A/02D në Malishevë.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1068/2021, i paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Alban Mazerku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, me të cilën pretendon se në vendvotimin 3016A/01R janë arrestuar 2 person, një vëzhgues e tjetër komisioner nën dyshimin për shitblerje të votave, ndërsa në vendvotimin 3013A/01R dhe 3013A/02D është raportuar se ka marrë 13 vota ndërsa pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja i kanë dalë vetëm 7 vota, andaj kërkon rinumërimin e këtyre vendvotimeve.

Si dëshmi ka bashkangjitur raportet e vëzhguesve, lajmet nga disa portale sa i përket arrestimit të dy personave, disa biseda në rrejte sociale, Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Alban Mazerku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekur, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimet e lartcekura është i pabazuar .

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, sa i përket vendvotimit 3016A/01R ku apeluesi pretendon për parregullsi në ditën e votimit dhe për këtë janë arrestuar dy persona nga policia paneli këtë fakt e vlerësoi si jo relevant pasi që procedimi penal për të apostrofuarit nuk ndërlidhet me mungesën e votave të pretenduara nga apeluesi. Ndërsa sa i përket vendvotimeve 3013A/01R dhe 3013A/02D paneli nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.1068/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesi e Panelit**  
**Milena Đerić**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.